



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Nr. 076/17
Data. 16.07.2022

Prishtinë, 08 shkurt 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1488_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47, Nenin 48, dhe Nenin 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 27 dhe 28 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat ligjore të Rregullës Nr. 05/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së);
- Parimet për përcaktimin të ngarkesave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes;
- Metodologjinë për përcaktimin e ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes;
- Vendimin V_1485_2022 të datës 07 shkurt 2022 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH;
- Propozimin e OSSH-së për aprovimin e tarifave të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të dorëzuar më datë 07 shkurt 2022,

në seancën e mbajtur më 8 shkurt 2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (Tarifa SHSSH), që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) duke filluar nga data 09 shkurt 2022 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
- II. Struktura e tarifave SHSSH që zbatohet nga OSSH është dhënë në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Tarifat për shfrytëzimin e rrjetit të shpërndarjes		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€c/kWh	1.69
10 kV	€c/kWh	2.56
0.4 kV	€c/kWh	3.86

- III. Ky Vendim do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) duke filluar nga data 09 shkurt 2022 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 13 dhjetor 2021 ka iniciuar Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar, duke përfshirë edhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- o ZRRE sipas njoftimit të saj, ka vlerësuar se ekzistojnë argumente të qarta dhe në bashkërendim me procesin e fundit tarifor, ka konstatuar se ka indikacione të tejkalimit të pragut të materialitetit prej 5 % në të Hyrat e Lejuara Maksimale të operatorëve të rregulluar të energjisë elektrike.
- o ZRRE në vazhdimësi ka monitoruar situatën e furnizimit me energji elektrike dhe nga analizat e bëra, ka konstatuar se si pasojë e mbizotërimit të çmimeve të larta të energjisë elektrike në bursat ndërkombëtare, është rrezikuar siguria e furnizimit për konsumatorët fundorë me energji elektrike. Duke qenë se kostot e blerjes së energjisë me shumicë janë jasht kontrollit të operatorëve, konform kornizës ligjore të rregullimit, ZRRE ka inicuar shqyrtim të jashtëzakonshëm të HLM për operatorët e rregulluar, me qëllim të ruajtjes së sigurisë së furnizimit për konsumatorët e energjisë elektrike dhe reflektimit të kostove të furnizimit.
- o Prandaj, mbështetur në kornizën ligjore në fuqi, ka hapur shqyrtimin e jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH.
- o ZRRE më datë 28 dhjetor 2021 nga OSSH ka pranuar aplikacionin për të Hyrat e Lejuara Maksimale.
- o ZRRE më 17 janar 2022 ka publikuar Raportin Konsultativ - Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar.
- o Raporti Konsultativ ka paraqitur qëndrimet e ZRRE-së për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të HLM për të mbuluar ndryshimin e ndjeshëm në kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe për të garantuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët. Raporti është vënë


në diskutim publik me synimin që të marrë komentet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së.


- OSSH ka dorëzuar komente më datë 27 janar 2022 ndaj Raportit Konsultativ Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar.
 - ZRRE ka trajtuar të gjitha komentet e OSSH-së si dhe komentet e palëve të interesit, lidhur me detyrimet e saj në përmbushjen e obligimeve ligjore dhe rregullative, duke i paraqitur në Raportin Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar.
 - Raporti përfundimtar i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar, përfshirë edhe të operatorit të sistemit të shpërndarjes, përfshinë vlerësimet përfundimtare dhe përgjigjet në komente të palëve të interesit.
 - Bordi i ZRRE-së, me datë 07 shkurt 2020 përmes Vendimit V_1485_2022 ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, përmes tarifave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes për periudhën shkurt 2022 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
 - Bordi i ZRRE-së me datë 07 shkurt 2022 përmes Vendimit V_1485_2022 ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH, në vlerë prej 179,555,073 Euro.
 - Sipas Vendimit V_1485_2022, OSSH duhet t'i përgatisë dhe dorëzojë për aprovim në ZRRE tarifat për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes.
 - ZRRE më datë 07 shkurt 2022 nga OSSH ka pranuar propozimin për tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes.
 - Propozimi i OSSH për tarifat e shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes është bërë duke ndarë kostot dhe rrjedhat e energjisë për periudhën janar-shkurt 2022 dhe mars - dhjetor 2022.
 - Tarifat e propozuara nga OSSH do të mbi vlerësonte kostot e shërbimit për periudhën Mars-dhjetor.
 - Prandaj, Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të propozimit për tarifat e Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarje, duke u bazuar në vendimin V_1485_2022 për të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH dhe Metodologjinë për përcaktimin e ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes, ka kalkuluar tarifat SHSSH për kostot e shërbimit për vitin relevant tarifor 2022, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Pejzullahu, kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtar


Gani Bdrhaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS SH.A),dhe
- Arkivit të ZRRE-së.